



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Ref. nr. 01 / 2197 / Dt. 14 / 12 /2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
UNIVERSITETIT PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN DHE DREJTORATI I ARSIMIT NË GJILAN
E lidhur më datë : 14.12.2020 ndërmjet:

- 1) **Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, rr. "Zija Shemsiu" p.n.**
 - Përfaqësuar nga Rektori, Prof.Asoc. Dr. Bajram Kosumi
 - Në tekstin e mëtejme si UKZ

- 2) **Drejtorati i Arsimit Gjiilan, rr. "Mustafë Koka"**
 - Përfaqësuar nga drejtori, MSc. Nazim Gagica
 - Në tekstin e mëtejme si DKA

(Tani e tutje, së bashku do tu referohemi si "Palët")

Neni1
Përkufizimet

Palët janë marrë vesh si më poshtë:

Palët – Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiilan janë palë nënshkruese të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e cila marrëveshje përfshinë shfrytëzimin e konviktit të shkollave të mesme së bashku me mensën dhe sallën e edukatës fizike për studentët e UKZ-së.

Marrëveshje Bashkëpunimi – nënkupton Marrëveshjen e mëposhtme me të gjitha anekset.

Neni 2

Qëllimi

- a) Në UKZ studiojnë studentë nga të gjitha rajonet e Kosovës dhe më gjerë, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia Veriore, largësia gjeografike e të cilave është edhe mbi 40 km nga UKZ dhe kjo na obligon që të zgjidhim banimin dhe ushqimin për studentët tanë.
- b) Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të përcaktoj kushtet e bashkëpunimit ndërmjet palëve për pranimin, akomodimin, banimin dhe ushqimin e studentëve të UKZ-së në Konviktin që graviton në Kampusin e Shkollave të Mesme të Larta në Gjiilan.
- c) Konvikti në kampusin e shkollave të mesme të larta është shumë afër objektit të UKZ-se rreth 50m. Konvikti gjithashtu ka mensën në të cilën mundën të ushqehen studentët tanë të cilët për shkak kushteve të tyre do të banonin në Konvikt.

Neni 3

Detyrimet e Palëve

Palët marrin përsipër të përmbushin detyrimet me sa vijon:

- a) Menagjmenti i Konviktit do të bëjë përzgjedhjen e studentëve të dalluar dhe kritereve tjera të cilët do të fitojnë të drejtën e banimit në konvikt.
- b) Përzgjedhja do të bëhet në baza meritore, varësisht nga numri i studentëve të cilët kanë nevojë .
- c) Varësisht se si e kërkon menagjmenti, përzgjedhja e studentëve do të bëhet sipas notës mesatare, ku si kriter bazë do të jetë nota më e madhe dhe largësia gjeografike.
- d) Drejtorati i Arsimit është i obliguar që pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, të pranoj një numër të caktuar studentësh nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjiilan dhe ti sistemoj në dhomat e Konviktit.
- e) Studentët janë te obliguar që të kryejnë pagesën e caktuar për banim dhe ushqim. Gjithashtu studentët janë të obliguar të respektojnë rregullat dhe rendin shtëpiak të Konviktit për banim dhe mensës për ushqim.

Neni 4

- a) Palët janë dakorduar edhe për shfrytëzimin e hapësirës së Sallës së edukatës fizike nga studentët e UKZ-së në kompleksin e shkollave të mesme pa e penguar mësimin e shkollave të mesme.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje, do të jetë e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri sa palët ta shkëpusin marrëveshjen e tillë. Nëse asnjëra palë, nuk e ndërprejnë bashkëpunimin 3 (tre) muaj apo 90 (nëntë dhjetë) ditë para përfundimit të periudhës pesë vjeçare, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme edhe për tre vite të tjera.

Në rast se njëra palë dëshiron të shkëpus marrëveshjen, ajo duhet së paku tre (3) muaj para ta paralajmëroj palën tjetër se dëshiron ta shkëpusë marrëveshjen.

Në rast të tillë, palët që mbeten do të konsultohen për vazhdimësinë e zbatimit të kësaj Marrëveshje dhe do të nxjerrin së bashku një vendim të përbashkët me shkrim.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj.

Neni 7
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përbëhet nga 7 (shtatë) nene dhe është shkruar në gjuhën shqipe, në tri kopje dhe është e nënshkruar nga palët më datë 14.12.2020.

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN vs
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor

DREJTORATI I ARSIMIT GJILAN
Z. Nazim Gagica, Drejtor